



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



10-16 NËNTOR

JAVA E MBROJTJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

SHQIPËRIA-ITALI MARRËVESHJE NË FUSHËN E MBROJTJES

Në kuadër të samitit të parë ndërqeveritar mes Shqipërisë dhe Italisë, të mbajtur në Romë nën drejtimin e kryeministres italiane Giorgia Meloni dhe kryeministrit Edi Rama, u firmos një marrëveshje e rëndësishme në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe homologu i tij italian, Guido Crosetto nënshkruan “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes”, e cila synon forcimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik dhe të sigurisë dypalëshe.

★★★★★

SHQIPËRI- ITALI ZGJEROJNË BASHKËPUNIMIN NË MBROJTJE

Në Samitin Ndërqeveritar të mbajtur në Romë, Ministria e Mbrojtjes e Italisë dhe ajo e Shqipërisë firmosën disa marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes. Marrëveshjet mbulojnë zhvillimin e industrisë ushtarake, forcimin e kapaciteteve të emergjencave civile dhe modernizimin e Forcës Detare, duke forcuar partneritetin strategjik mes dy vendeve.

★★★★★



PROJEKTBUXHETI I MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, prezantoi në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes projektbuxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2026, të cilin e cilësoi si më ambiciozin që prej anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Sipas ministrit Vengu, buxheti i vitit të ardhshëm parashikon 58,9 miliard lekë, një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2025, ndërsa theksoi se për herë të parë buxheti arrin në nivelin 2,12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

★★★★★



OFICERË / KOLONEL

163,500 lekë → 167,588 lekë

+ 4,088 LEKË

RRITJE PAGASH PËR USHTARAKËT NË BUXHETIN 2026

Qeveria Shqiptare ka parashikuar rritje pagash për ushtarakët e Forcave të Armatosura në Projektbuxhetin 2026, si pjesë e politikës së qëndrueshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës. Rritja shkon deri në 5,875 lekë, duke përfshirë të gjitha nivelet, nga Ushtari IV deri te Gjeneral Lejtnanti, si dhe shtesa për kushtet e punës dhe trajtimin ushqimor.

★★★★★

mod.gov.al

JM

KONTINGJENTI X I FD NIS MISIONIN NË DETIN EGJE

Kontingjenti X i Forcës Detare u nis drejt Detit Egje për të marrë pjesë në operacionin NATO “Sea Guardian”. Efektivët shqiptarë do të përfaqësojnë vendin me profesionalizëm, duke kontribuar në sigurinë detare dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ceremonia e nisjes përfundoi me dorëzimin e Flamurit Kombëtar dhe një foto të përbashkët.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

78 VITE KOMANDA MBËSHTETËSE NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT

Komanda Mbështetëse shënon 78-vjetorin e krijimit, duke vijuar misionin e saj në gjithë Shqipërinë dhe në operacionet e Aleancës. Forcat xheniere, mjekët ushtarakë dhe zjarrfikësit mbeten në vijën e parë të emergjencave, duke ofruar mbështetje për komunitetet dhe duke shpëtuar jetë

JM



mod.gov.al

MINISTRI VENUGU NDERON TË RËNËT FRANCEZË NË KORÇË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu mori pjesë në ceremoninë e 11 Nëntorit në Varrezat Franceze të Korçës, ku u nderuan 640 të rënët e Luftës së Parë Botërore. Ai theksoi miqësinë e hershme shqiptaro-franceze dhe rolin historik të Korçës në periudhën e vetëqeverimit shqiptar. Ministri u shpreh se kujtimi i të rënëve na rikujton se liria dhe paqja kërkojnë sakrificë dhe mbrojtje të përditshme.

★★★★★



STËRVITJA “SCIABOLA DI BRONZO 25”

Efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut morën pjesë nga data 1 deri në 7 nëntor 2025 në stërvitjen e përbashkët “Sciabola di Bronzo 25” me Regjimentin e 7-të Alpin të Ushtrisë Italiane në Monte Biviera, duke demonstruar profesionalizëm dhe aftësi luftarake në kushte të vështira malor.

JM





STËRVITJE SHQIPTARO-RUMUNE

Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan një stërvitje dypalëshe me Ushtrinë Rumune në Sarajevë, në kuadër të misionit EUFOR “ALTHEA”. Aktiviteti synon forcimin e bashkëpunimit mes vendeve aleate dhe rritjen e gatishmërisë operacionale. Shqipëria vijon të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në kuadër të EUFOR





KONTINGJENTI I XVIII EOD NISËT NË LETONI

Kontingjenti i XVIII EOD, do të atashohet Brigadës Shumëkombëshe Letoneze, në kuadër të Forcës së Përparuar Tokësore, një moment i rëndësishëm që shënon angazhimin e radhës së Forcave Tona të Armatosura në operacionet dhe misionet ndërkombëtare. Kontingjenti pritet të zhvillojë detyra të specializuara EOD në Letoni përgjatë gjashtë muajve të ardhshëm.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



TRAJNIM NGA INSTITUTE FOR SECURITY GOVERNANCE

Nga data 10–14 nëntor, Institute for Security Governance (ISG) zhvilloi një trajnim intensiv me pjesëmarrjen e personelit nga Drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm, Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes. Fokusi kryesor i trajnimit ishte integrimi operacional i hapësirës kibernetike, veçanërisht gjatë procesit të planizimit të përbashkët, përmes skenarëve hipotetik të sulmeve ndaj infrastrukturave kritike ushtarake dhe civile.

★★★★★

mod.gov.al

JM



“MBROJTJA CIVILE NË TURNE” NDALET NË LEZHË

Fushata Kombëtare “Mbrojtja Civile në Turne” u ndal këtë herë në Lezhë, ku sheshi qendror u kthye në hapësirë demonstrimesh për përgatitjen ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike. Aktivitetet përfshinë simulimin e një zjarri, demonstrime të ndihmës së parë dhe materiale edukative për vetëmbrojtje në raste emergjencash. Fushata mbështetet nga AKMC, UNDP dhe partnerë ndërkombëtarë.

★★★★★